

VENDIM
Nr. 413, datë 15.5.2013

**PËR RIALOKIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN
2013, NDËRMJET INSTITUTIT TË GJEOGRAFISË USHTARAKE DHE AUTORITETIT
SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012
“Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) t’i shtohen 21 (njëzet e një) punonjës për vitin 2013 nga reduktimi i 40 (dyzet) punonjësve të Institutit të Gjeografisë Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6010) në Ministrinë e Mbrojtjes, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve në nivel ministrie, për vitin 2013, në 10 150 (dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) veta.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Shërbime për shoqërinë e informacionit”, të shtohet fondi 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë për shpenzime korente për ASIG-un, i cili të përballohet nga reduktimi, në të njëjtën masë, i shpenzimeve korente të programit “Mbështetja e luftimit” (Reparti Ushtarak nr. 6010) të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha